

Бр. / Nr. 02-8269/1
22-12-2025 20 ____ год. / viti

Në bazë të nenit 308 paragrafi 1 të Ligjit të Mbrojtjes Sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/22, 236/22, 65/23 dhe 192/25), Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve miratoi:

VENDIM

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE SOCIALE NË SHTËPI, PËR MBROJTJE JASHTËFAMILJARE, PËR NDIHMË DHE MBËSHTETJE PROFESIONALE, PËR QËNDRIM DITOR, PËR QËNDRIM TË PËRKOHSHËM, PËR KËSHILLIM DHE PËR ZËVENDËSIM TË KUJDESIT FAMILJAR
për vitin 2026**

Neni 1

Me këtë Vendim përcaktohen çmimet e shërbimeve sociale të ofruara nga ofruesit e shërbimeve të autorizuar për vitin 2026.

Neni 2

- Me këtë Vendim përcaktohen çmimet e llojeve të mëposhtme të shërbimeve:
 - 1. **Shërbime në shtëpi**
 - Kujdes dhe ndihmë në shtëpi
 - Asistencë personale
 - 2. **Shërbime për kujdes jashtëfamiljar**
 - Jetesë me mbështetje,
 - Kujdes në familje tjetër,
 - Akomodim në institucion trajtimi dhe rehabilitimi për njerëzit me probleme varësie dhe njerëz të tjerë të marginalizuar.
 - 3. **Shërbime të ndihmës dhe mbështetjes profesionale**
 - Qendra e mbështetjes së familjeve kujdestare
 - 4. **Shërbime për qëndim ditor**
 - Qendra e Kujdesit Ditor për Fëmijë në Rrezik dhe Fëmijë në Konflikt me Ligjin,
 - Qendra e Kujdesit Ditor për Personat me Aftësi të Kufizuara,
 - Qendra e Kujdesit Ditor për Personat me Aftësi të Kufizuara me Punë Individuale,
 - Qendër Kujdesi Ditor për të Moshuarit,

- Qendër Kujdesi Ditor për të Pastrehët,
- Qendër Rehabilitimi dhe Riintegrimi, dhe
- Qendër Risocializimi.

• 5. Shërbime të Qëndrimit të Përkohshëm

- Qendër qëndrimi e përkohshme për fëmijët që gjenden pa kujdes prindëror ose që enden dhe për fëmijët viktimë të abuzimit,
- Qendër qëndrimi e përkohshme për viktimat e dhunës në familje,
- Qendër qëndrimi e përkohshme për viktimat e dhunës me bazë gjinore,
- Qendër qëndrimi e përkohshme për gratë viktimë të dhunës seksuale dhe të përdhunimit,
- Qendër qëndrimi e përkohshme për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore,
- Qendër qëndrimi e përkohshme për të pastrehët.

• 6. Shërbime të Këshillimit

- Shërbime parësore të këshillimit
- përgatitje për pjesë,
 - përgatitje për jetën familjare,
 - përgatitje për prindërim,
 - përgatitje për planifikim familjar,
- Shërbime dytësore të këshillimit:
 - këshillim martesor/partneriteti për partnerë me marrëdhënie problematike,
 - këshillim për divorc,
 - ndërmjetësim familjar për familje me marrëdhënie familjare problematike,
 - mbështetje psiko-sociale për viktimat e dhunës në familje,

Shërbime terciare të këshillimit:

- trajtim psikosocial i autorëve të dhunës në familje,
- trajtim psikosocial i grave viktimë të dhunës dhe dhunës në familje, dhe
- lloje të tjera të specializuara të këshillimit.

• 7. Zëvendësim të kujdesit familjar

- Zëvendësim të kujdesit familjar për person të moshuar,
- Zëvendësim të kujdesit familjar për person me aftësi të kufizuara,
- Zëvendësim të kujdesit familjar për person të sëmurë dhe të dobët.

Neni 3

- Si kosto të shërbimeve të nenit 2 të këtij Vendimi, kostot që ndërlidhen me ofrimin e shërbimit merren si elementë për formimin e çmimit të shërbimit, dhe atë:
- • Kompensimi për burimet njerëzore,
- • Mallrat dhe shërbimet,
- • Kompensimi për përdorimin e hapësirës.

Shpenzimet e paragrafit 1 të këtij neni përlllogariten në përputhje me Metodologjinë për Përcaktimin e Çmimeve të Shërbimeve në Varësi të Standardeve dhe Normave për Ofrimin e Shërbimeve Sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 264/19).

Neni 4

Çmimi i shërbimit social të ndihmës dhe kujdesit në shtëpi, i përlllogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, e në varësi të Rregullores së Mënyrës dhe Vëllimit të Shërbimeve Sociale, Normave dhe Standardeve për Ofrimin e Shërbimit Social të Ndihmës dhe Kujdesit në Shtëpi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 268/19, 198/21 dhe 75/23), është 409 denarë në orë për përfitues.

Neni 5

Çmimi i asistencës personale të shërbimit social, i përlllogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, e në varësi të Rregullores së Mënyrës dhe Vëllimit të shërbimeve sociale, Normave dhe Standardeve për Ofrimin e Shërbimit Social të Asistencës Personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 264/19), është 389 denarë në orë për përfitues.

Neni 6

Çmimi i shërbimit social për jetesë me mbështetje, i përlllogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, dhe varësisht nga Rregullorja e Mënyrës dhe Vëllimit të Shërbimeve Sociale, Normave dhe Standardeve për Ofrimin e Shërbimeve Sociale për Jetesë me Mbështetje ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 264/2019 dhe 34/23), është:

- 44.780 denarë në muaj për jetesë me mbështetje 24-orëshe për fëmijë pa prindër ose kujdes prindëror, përkatësisht 1.468 denarë në ditë për përfitues,
- 28.527 denarë në muaj për jetesë me mbështetje të organizuar të herëpashershme për persona me aftësi të kufizuara, përkatësisht 935 denarë në ditë për përfitues,

- 39.363 denarë në muaj për jetesë me tetë orë mbështetje ditore për personat me aftësi të kufizuara, përkatësisht 1.291 denarë në ditë për përfitues,
- 50.199 denarë në muaj për mbështetje 24-orëshe për personat me aftësi të kufizuara, përkatësisht 1.646 denarë në ditë për përfitues.

Neni 7

Çmimi i shërbimit social të kujdesit familjar në një familje tjetër, i përlogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, e në varësi të Rregullores së Kriterëve më të Përafërta për Përzgjedhjen e Familjes Kujdestare, Llojit dhe Numrit të Përfituesve që Mund të Vendosen në Familje Kujdestare, Standardeve për Ofrimin e Shërbimit të Kujdesit Familjar, Normave dhe Standardeve për Kryerjen e Veprimtarisë së Qendrës për Mbështetjen e Familjeve Kujdestare, për Hapësirën, Mjetet, Stafin dhe Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës dhe të Dokumentacionit të nevojshëm për Familjet Kujdestare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 288/20), përlogaritet në varësi të llojit të familjes kujdestare.

Kostoja e shërbimit social për kujdesin në familje kujdestare të përgjithshme, në varësi të numrit të fëmijëve të vendosur në një familje, është:

- 22,015 denarë në muaj për fëmijë, kur kujdeset një fëmijë,
- 18,910 denarë në muaj për secilin fëmijë, kur kujdesen dy fëmijë,
- 16,823 denarë në muaj për secilin fëmijë, kur kujdesen tre fëmijë,
- 15,324 denarë në muaj për secilin fëmijë, kur kujdesen katër fëmijë,
- 14,195 denarë në muaj për secilin fëmijë, kur kujdesen pesë fëmijë.

Kostoja e shërbimit social për kujdesin familjar në familje kujdestare në lidhje gjaku, në varësi të numrit të fëmijëve të vendosur në një familje, është:

- 15,662 denarë në muaj për fëmijë, kur kujdeset një fëmijë,
- 12,591 denarë në muaj për secilin fëmijë, kur kujdesen dy fëmijë,
- 10,527 denarë në muaj për secilin fëmijë, kur kujdesen tre fëmijë,
- 9,044 denarë në muaj për secilin fëmijë, kur kujdesen katër fëmijë,
- 7,927 denarë në muaj për secilin fëmijë, kur kujdesen pesë fëmijë.

Çmimi i shërbimit social për kujdesin në kujdestari ndërhyrëse të familjes tjetër është 22.530 denarë në muaj, përkatësisht 739 denarë në ditë për përfitues.

Kostoja e shërbimit social për kujdesin në familje kujdestare të specializuar, në varësi të numrit të fëmijëve të vendosur në një familje, është:

- 27,643 denarë në muaj për person me aftësi të kufizuara, kur kujdeset për një person, ose 906 denarë në ditë për përfitues.
- 23,487 denarë në muaj për person me aftësi të kufizuara, kur kujdeset për dy persona, ose 770 denarë në ditë për përfitues,
- 24,389 denarë në muaj për fëmijë/person në rrezik, ose 800 denarë në ditë për përfitues.

Neni 8

Çmimi i shërbimit social të trajtimit dhe rehabilitimit në komunitet terapeutik, i përlogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, dhe në varësi të Rregullores së Normave dhe Standardeve Lidhur me Hapësirën, Mjetet dhe Personelin dhe dokumentacionin e Nevojshëm për Ofrimin e Shërbimit Social, vendosje në institucion për trajtimin dhe rehabilitimin e personave me aftësi të kufizuara, personave me probleme varësie dhe personave të tjerë të marginalizuar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 268/19) është 42.384 denarë në muaj për përfitues për shërbim 24-orësh ose 1.390 denarë në ditë për përfitues.

Neni 9

Çmimi i shërbimit social për ndihmë dhe mbështetje profesionale, të ofruar përmes Qendrës për Mbështetjen e Familjeve Kujdestare, i përlogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, dhe në varësi të Rregullores së Kriteve të Përafruara për Përzgjedhjen e Familjes Kujdestare, Llojt dhe Numrit të Përfituesve që Mund të Vendosen në Familje Kujdestare, Standardeve për Ofrimin e Shërbimit Kujdestar, Normave dhe Standardeve për Kryerjen e Veprimtarisë së Qendrës për Mbështetje të Familjes Kujdestare, për Hapësirën, Mjetet, Personelin dhe Mënyrën e Mbajtjes së Evidencës dhe të Dokumentacionit të Nevojshëm për Familjet Kujdestare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 288/20), është 8.866 denarë në muaj për shërbim të caktuar për familje kujdestare.

Neni 10

Çmimi i shërbimit social për qëndrim ditor, i përlogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, e varësisht Rregullores së Mënyrës, Vëllimit, Normave dhe Standardeve për Ofrimin e Shërbimeve Sociale për Qëndrimin Ditor, Rehabilitimin, Riintegrimin dhe Risocializimin, si dhe për Hapësirën, Mjetet, Personelin të përcaktuar nga niveli i kualifikimeve dhe i profileve sipas llojit të shërbimit dhe të numrit të përfituesve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për qendër të qëndrimit ditor, qendër rehabilitimi dhe qendër risocializimi ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 150/20, 172/21 dhe 47/23) përcaktohet në shumat e mëposhtme:

- 20.938 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim ditor për fëmijë në rrezik për çdo përdorues, përkatësisht 952 denarë në ditë për përfitues,

33.489 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim ditor për persona me aftësi të kufizuara, përkatësisht 1.522 denarë në ditë për përfitues,

- 1.411 denarë për trajtim individual në qendër për qëndrim ditor për persona me aftësi të kufizuara,

- 16.997 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim ditor për të moshuarit, përkatësisht 773 denarë në ditë për përdorues,
- 10.092 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim ditor për të moshuarit me plakje aktive, përkatësisht 459 denarë në ditë për përfitues,
- 18.714 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim ditor për persona të pastrehë, përkatësisht 851 denarë në ditë për përfitues,
- 16.996 denarë në muaj për përfitues të shërbimit ditor në qendër rehabilitimi dhe riintegrimi dhe qendër risocializimi, përkatësisht 773 denarë në ditë për përfitues.

Çmimi mujor i paragrafit 1 të këtij neni përlogaritet për 22 ditë pune.

Neni 11

Çmimi i shërbimit social për qëndrim të përkohshëm, i llogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij vendimi, dhe varësisht Rregullores së Mënyrës, Vëllimit, Normat dhe Standardet për Ofrimin e Shërbimit Social për Qëndrim të Përkohshëm dhe për Hapësirën, Mjetet, Personelin dhe Dokumentacionin e Nevojshëm për Qendër për Qëndrimi të Përkohshëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 91/21), është:

57.294 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim të përkohshëm për fëmijë që gjenden pa kujdes prindëror ose që enden përreth dhe fëmijë që janë viktimat të abuzimit, përkatësisht 1.878 denarë në ditë për përfitues,

44.920 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim të përkohshëm për viktimat e dhunës në familje, qendër për viktimat e dhunës në bazë gjinore dhe qendër për gratë viktimat të dhunës seksuale dhe të përdhunimit, përkatësisht 1.473 denarë në ditë për përfitues,

53.207 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim të përkohshëm për viktimat e trafikimit me njerëz, përkatësisht 1.744 denarë në ditë për përfitues,

45.413 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim të përkohshëm për viktimat e trafikimit me qenie njerëzore, përkatësisht 1.489 denarë në ditë për përfitues, pa shpenzimet e regjisë.

27.798 denarë në muaj për përfitues shërbimi në qendër për qëndrim të përkohshëm për të pastrehët, përkatësisht 911 denarë në ditë për përfitues.

Neni 12

Çmimi i shërbimit të këshillimit, i cili përdoret në këshillimore, i përlogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, dhe varësisht Rregullores së mënyrës, Vëllimit, Normave dhe Standardeve për Ofrimin e Shërbimeve të Këshillimit dhe për hapësirën, Mjetet, Personelin dhe Dokumentacionin e Nevojshëm për Këshillimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 84/21 dhe 3/24) përcaktohet në shumat e mëposhtme:

Shërbime parësore të këshillimit:

- 1,223 denarë për këshillim individual në orë për përfitues,
- 330 denarë për këshillim në grup në orë për përfitues.

Shërbime dytësore të këshillimit:

- 2,355 denarë për këshillim individual në orë për përfitues,
- 512 denarë për këshillim në grup në orë për përfitues.

Shërbime terciare të këshillimit:

- 3.060 denarë për këshillim individual në orë për përfitues, për trajtim psikosocial të autorëve të dhunës në familje,
- 824 denarë për këshillim në grup në orë për përfitues, për trajtim psikosocial të autorëve të dhunës në familje,
- 2.526 denarë për këshillim individual në orë për përfitues, për trajtim psikosocial të grave viktime të dhunës dhe dhunës në familje, dhe lloje të tjera të specializuara të këshillimit,
- 675 denarë për këshillim në grup për orë për përfitues, për trajtim psikosocial të grave viktime të dhunës dhe dhunës në familje, si dhe lloje të tjera të specializuara të këshillimit.

Neni 13

Çmimet për shërbimin social për zëvendësim të kujdesit familjar, të përlogaritur në përputhje me nenin 3 të këtij Vendimi, dhe varësisht Rregullores së Mënyrës, Vëllimit, Normave dhe Standardeve për Ofrimin e Shërbimit Social Zëvendësim të Kujdesit Familjar dhe për Hapësirën, Mjetet, Personelin dhe Dokumentacionin e Nevojshëm për Qendër për Zëvendësim të Kujdesit Familjar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 53/21 dhe 113/23) janë:

- Zëvendësim për kujdes familjar për person të moshuar 1,006 denarë në ditë për përfitues,

- Zëvendësim për kujdes familjar për person me aftësi të kufizuara 1,027 denarë në ditë për përfitues,
- Zëvendësim për kujdes familjar për person të sëmurë dhe të dobët 956 denarë në ditë për përfitues.

Neni 14

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij, ndërkaq do të gjejë zbatim nga 1 janari i 2026-ës.

Në ditën e zbatimit të këtij Vendimi, pushon të vlejë Vendimi për Përcaktimin e Çmimeve të Shërbimeve Sociale në Shtëpi, për Kujdesin Jashtëfamiljar, për Ndihmën dhe Mbështetjen Profesionale, për Qëndrimin Ditor, për Qëndrimin e Përkohshëm, për Këshillimin dhe për Zëvendësimin e Kujdesit Familjar për vitin 2025 nr. 02-8155/2, dt. 18.12.2024.

Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve
Fatmir Limani

